

MATRICA E REKOMANDIMEVE PËR INFORMALITETIN NË SHQIPËRI		SEKRETARIATI KËSHILLI I INVESTIMEVE DHJETOR 2015
SHTYLLA	REKOMANDIMI	AFATI
A. Reformë Formalizimi- Partneritet Me Biznesin	1. Përgatitja dhe miratimi nga Këshilli i Ministrave i një Strategjie të mirëfilltë kundër ekonomisë informale mbi bazën e analizave sektoriale, që konsideron punën e deritanishme dhe krijon imazhin e një angazhimi serioz në afatgjatë të Qeverisë. Dokumenti të shoqërohet me një plan veprimi, me qasje sektoriale, afate kohore dhe institucione përgjegjëse të mirëpërcaktuara, të konsultuara dhe bashkërenduara me përfaqësuesit e biznesit	Afatshkurtër
B. Sistem Tatimor i Përgjegjshëm Kundrejt Formalizimit	2. Rivlerësim dhe analizë e sistemit fiskal aktual (barra dhe politika fiskale) nëse dekurajon apo inkurajon formalizimin mbi bazën e elementeve të mëposhtëm : a) Debati mbi pragun e TVSH/Tatim Fitimi b) Incentiva që mund të shoqërojnë luftën ndaj informalitetit	Afatmesëm

	3. Thjeshtim i burokracive administrative duke synuar reduktimin e numrit dhe kohës së kryerjes së pagesave në veçanti për biznesin e mesëm, të vogël dhe mikro, dhe vendosja në dispozicion të tatimpaguesve të shërbimeve inovative. 4. Rritja e përgjegjshmërisë së administratës për t'ju përgjigjur reformës së formalizimit.	Afatshkurtër Afatshkurtër
C. Sistemi Rregullator, Mbështetës i Formalizimit	5. Reforma për formalizim duhet të ketë si objekt edhe lehtësimin e barrës administrative për tatimpaguesit duke nxitur pajtueshmërinë me sistemin tatimor dhe sistemin rregullator. a) Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve publike në drejtim të aplikimit të sistemeve online dhe rritje e shkëmbimit të informacionit në kohë reale. b) Kategorizim i saktë i profesioneve si në aspektin ligjor dhe administrativ c) Unifikimi i strukturave të hetimit dhe kontrollit të Administratës Tatimore dhe Doganore d) Përcaktim i qartë ligjor i tregjeve të shumicës dhe pakicës e) Formalizimi në bujqësi.	Afatmesëm
D. Aksesit në kredi dhe shërbimet financiare, faktorë incentivues për formalizimin.	6. Të konsiderohet bashkëpunimi i mëtijshëm me institucionet financiare bankare dhe institucionet financiare jo-bankare në kontekstin e strategjisë së formalizimit dhe përfitimeve. • Rritja e aksesit në shërbimet bankare. • Inkurajimi i transaksioneve bankare dhe pagesave elektronike	Afatmesëm

E. Konsultim, Transparencë dhe Edukim	7. Të zbatohet Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” 8. Iniciimi i programeve e granteve dhe kreditimit të Qeverisë dhe Donatorëve mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ndërgjegjësimin dhe këshillimin për formalizim të grupeve të caktuara të sektorit privat. • Më shumë këshillim dhe ndërgjegjësim për fermerët • Iniciimi i fushatave ndërgjegjëse të targetuara në bashkëpunim edhe me shoqatat e biznesit apo partnerë të tjerë privatë si institucionet e mikrokreditimit në zonat rurale • Vlerësim publik për bizneset e rregullta.	Afatmesëm
---	---	-------------------------

Matrica e Rekomandimeve për Informalitetin në Shqipëri (Matrica), është rezultat i Dokumentit të Punës i përgatitur nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve në Dhjetor 2015. Qëllimi i Matricës është të përmbledhë Rekomandimet dhe Zgjidhjet e propozuara në Dokumentin e Punës. Gjithashtu, Matrica shërben edhe si një Plan i Brendshëm Monitorues i Sekretariatit në mënyrë që të ndjekë zbatimin e Rekomandimeve sipas afateve të mëposhtme:

- **Afatshkurtër**- periudhë nga 3 muaj në 6 muaj.
- **Afatmesëm** – periudhë nga 6 muaj në 1 vit.